

Nr. 2966/1 Prot

Durrës, më: 17.12.2025

VENDIM I PËRBASHKËT

Nr. 1, datë 17.12 2025

PËR

“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË MËSIMORE, KËRKIMORE - SHKENCORE DHE FINANCIARE, PËR VITIN AKADEMIK 2024 - 2025 NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS”

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 38 “Funksionet e Senatit Akademik” pika 1, gërma (l); të Udhëzimit Nr.24, datë 21.10.2019 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementeve përberëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”; Udhëzuesit të AKFAL “Për modelin e Raportimit Vjetor të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit”; në Statutin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës neni 15 “Funksionet e Senatit Akademik” pika 1, gërma (u), në Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, në shkresën e grupit të punës me Nr.2573/2 , datë 15.12.2025, në mbledhjen e përbashkët me datë 17.12.2025, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit,

VENDOSËN:

1. Miratimin e Raportit Vjetor të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore - Shkencore, dhe Financiare për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit.

Kryetar i Senatit Akademik

Prof.Dr. Shkëlqim Fortuzi

Kryetar i Bordit të Administrimit

Dr. Ada Aliaj

Konceptoi: F. Vezi,
Sp/ Sekretariati Teknik në Rektorat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2619/1 Prot.

Durrës, më 21.11.2025

V E N D I M

Nr. 84, datë 11.11.2025

PËR

**“MIRATIMIN E NJË SHTESE NË REGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN KALENDARIK 2025”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit Nr. 53, datë 19.08.2021 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e Rregullores Financiare të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në shkresën e Administratorit me Nr. 2502/1 prot., datë 31.10.2025 mbi “Kërkesë për një shtesë në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik, për vitin kalendarik 2025”, vendimi Senatit Akademik nr.134, datë datë 05.11.2025, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2025, në fondin limit 644,866 lekë pa TVSH, sipas shkresës së Administratorit me Nr. 2502/1 prot., datë 31.10.2025
 2. Burimi financimit do të jetë nga të ardhurat e institucionit.
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2619/2 Prot.

Durrës, më 11.11.2025

V E N D I M

Nr. 85, datë 11.11 2025

PËR

**“MIRATIMIN E NJË SHTESE NË REGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN KALENDARIK 2025”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit Nr. 53, datë 19.08.2021 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e Rregullores Financiare të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në shkresën e Administratorit me Nr. 2502/2 prot., datë 31.10.2025 mbi “Kërkesë për një shtesë në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik, për vitin kalendarik 2025”, vendimi Senatit Akademik nr.135, datë datë 05.11.2025, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2025, në fondin limit 361,666.7 lekë pa TVSH, sipas shkresës së Administratorit me Nr. 2502/2 prot., datë 31.10.2025.
2. Burimi financimit do të jetë nga të ardhurat e institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMITNr. 2618/3 Prot.Durrës, më 11. 11 .2025

V E N D I M

Nr. 86 , datë 11. 11 2025**“PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË REGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN KALENDARIK 2025”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit Nr. 53, datë 19.08.2021 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e Rregullores Financiare të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në shkresën e Administratorit me Nr. 2502 prot., datë 31.10.2025 mbi “Kërkesë për një shtesë në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik, për vitin kalendarik 2025”, vendimi Senatit Akademik nr.136, datë datë 05.11.2025, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

- Miratimin e shtesës në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2025, në kuadër të implementimit të projektit BECEE shtohen zërat, sipas shkresës së Administratorit me Nr. 2502 prot., datë 31.10.2025:
 - “Blerje materiale promovuese dhe kancelarie të nevojshme për aktivitetet e komunikimit dhe diseminimit të projektit BECEE” me fond limit 100 000 lekë pa TVSH nga fondet e projektit.
 - “Blerja dhe instalimi i pajisjeve dhe materialeve për hapësirën e bashkëpunimit (co-working space) dhe Qendrën e Inovacionit” me fond limit 400 000 lekë pa TVSH nga fondet e projektit.
 - “Krijimi i faqes web dhe mirëmbajtjen e saj për 24 muaj” me fond limit 300 000 lekë pa TVSH nga fondet e projektit.
- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve
 - Drejtoria e Administrimit FinanciarKy vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALLI



Nr. 2619/4 Prot.Durrës, më 11 . 11 .2025

V E N D I M

Nr. 87 , datë 11 . 11 . 2025

PËR

**“MIRATIMIN E NJË SHTESE NË VLERËN E ZËRIT TË PARASHIKUAR NË
REGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK
PËR VITIN KALENDARIK 2025”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit Nr. 53, datë 19.08.2021 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e Rregullores Financiare të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në shkresën e Administratorit me Nr. 2501 prot., datë 31.10.2025 mbi “Kërkesë për një shtesë në vlerën e zërit të parashikuar regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik, për vitin kalendarik 2025”, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në vlerën e zërit të parashikuar në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2025, përkatësisht objekti i prokurimit “Kolaudim punimesh për Ndërtimin e Godinës së Fakultetit të Studimeve Profesionale të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës” do të bëhet me fondin total 1,124,364.17 lekë pa TVSH, sipas shkresës së Administratorit me Nr. 2501 prot., datë 31.10.2025.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve
 - Drejtoria e Administrimit FinanciarKy vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

№ 2619/5 prot

Durrës, më 11 / 11 / 2025

V E N D I M

Nr 88, datë 11. 11. 2025

**"PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QERA TË AMBIENTEVE PËR VENDOSJEN
E ATM-ve TË BANKËS CREDINS NË GODINËN CURRILA DHE KAMPUSIN
UNIVERSITAR TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", shkresës nr.2500 prot., datë 31.10.2025 "Kërkesë për dhënie me qera" të Administratorit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies me qera të një ambienti me sipërfaqe 4 m², godina nr.1 të kampusit universitar të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës për vendosjen e ATM Banka Credins.
2. Miratimin e dhënies me qera të një ambienti me sipërfaqe 4 m², godina Currila të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës për vendosjen e ATM Banka Credins.
3. Vlera e qerasë mujore (përfshirë dhe konsumin e energjisë) do të jetë 11680 lekë në muaj për çdo ATM.
4. Shpërndarja e të ardhurave, për secilën nga objektet do të arkëtohen në llogarinë e të ardhurave të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës sipas faturës të lëshuar nga Institucioni.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Administratori
 - Drejtorja e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada **GLIAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2674 Prot.

Durrës, më 18.11 .2025

VENDIM

Nr. 89, datë 18.11 2025

**"PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË TARIFËS VJETORE TË ANTARËSIMIT TË
UAMD NË RRJETIN UNIMED PËR VITIN 2025"**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenit 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të UAMD, Rregullores së UAMD, Rregullores Financiare të UAMD, shkresës nr.2639, date 17.11.2025 të Rektorit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesës së tarifës vjetore së antarësimit të UAMD në rrjetin UNIMED, me vlerë 3000 euro, per vitin 2025.
2. Pagesa do të kryhet nga të ardhurat e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALLAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 29/44 Prot.

Durrës, më 11.12.2025

VENDIM

Nr 111, datë 11.12.2025

“PËR MIRATIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURSIVE, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026, TË CILËT PËRMBUSHIN KRITERET PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, QË NDJEKIN STUDIMET NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, PRANË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS”

Në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpërndarjes së bursave, për vitin akademik 2025 - 2026, për studentë të cilët vijojnë studimet në vitin e parë dhe pas të parit në ciklin e parë të studimeve dhe vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë sipas tabelës përmbledhëse bashkëlidhur të hartuar nga komisioni i verifikimit të bursave, 176 studentë, efekti financiar 15,840,000 lekë.
2. Efekti financiar do të përlllogaritet nga momenti i lindjes së të drejtës për përfitimin e bursës (plotësimi i kritereve).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtorja e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TE ADMINISTRIMIT
Ada ALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 29/4/2 Prot.

Durrës, më 11.12 2025

VENDIM
Nr. 112, datë 11.12.2025

**"PËR MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË NUMRIT TË STUDENTËVE
CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PLOTË, QË PËRJASHTOHEN NË MASËN 100% NGA
TARIFA E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026"**

Në mbështetje të nenit 4 "e drejta e studimit", nenit 49 "Funksionet e bordit të Administrimit", nenit 98 "të drejtat dhe detyrimet e studentëve" të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 dhe 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 dhe 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, VKM nr.698, datë 21.11.2018 Për një shtesë në Vendimin nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", VKM nr.779, datë 26.12.2018 " Për disa ndryshime në Vendimin nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" të ndryshuar, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Përjashtimin në masën 100%, nga tarifa vjetore e shkollimit, studentët të cilët vijnë studimet në ciklin e parë me kohë të plotë për vitin akademik 2025-2026 pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të cilët vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë, 176 studentë, efekti financiar 3,718,000 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Administratori
 - Drejtorja e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMITNr. 2914/3 Prot.Durrës, më 11.12.2025**VENDIM**
Nr. 113, datë 11.12.2025**PËR**
"PËR MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË NUMRIT TË STUDENTËVE
CIKLIT TË DYTË ME KOHË TË PLOTË, QË PËRJASHTOHEM NË MASËN 50% NGA
TARIFA E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026"

Në mbështetje të nenit 4 "e drejta e studimit", nenit 49 "Funkcionet e bordit të Administrimit", nenit 98 "të drejtat dhe detyrimet e studentëve" të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 dhe 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 dhe 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Përfundimin në masën 50%, nga tarifa vjetore e shkollimit, studentët të cilët vijojnë studimet në ciklin e dytë me kohë të plotë viti akademik 2025-2026 pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të cilët vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë, 170 studentë efekti financiar 5,874,000 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:

- Administratori
- Drejtorja e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALLAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2914/4 Prot.

Durrës, më 11.12.2025

V E N D I M

Nr. 114, datë 11.12. 2025

PËR

**“MIRATIMIN E NJË SHTESE NË REGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN KALENDARIK 2025”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit Nr. 53, datë 19.08.2021 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e Rregullores Financiare të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në shkresën e Administratorit me Nr. 2666 prot., datë 18.11.2025 mbi “Kërkesë për një shtesë në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik, për vitin kalendarik 2025”, vendimi Senatit Akademik nr.153, datë datë 21.11.2025, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2025, shtohet zëri “Blerje materiale promovuese për organizimin e këndit STARS EU në kuadër të 20 vjetorit të UAMD” në fondin limit 518,500 lekë pa TVSH, sipas shkresës së Administratorit me Nr. 2666 prot., datë 18.11.2025.
2. Burimi financimit do të jetë nga fondi i projektit STARS EU.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Ada ALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2914/5 prot.

Durrës, më 11/12 / 2025

VENDIM

Nr. 115, datë 11.12.2025

PËR

"MIRATIMIN E PARAFINANCIMIT TË PROJEKTIT INTERREG/ "BLUE ECOSYSTEM"

Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenit 49, gërma c, të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8 datë 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj", Ligjin, nr.43/2016 Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 533, datë 04.10.2017 "Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Europian, për programin Interreg V-B Adriatiko— Jonian (ADRION) 2014-2020", termat e referencës për "Interreg Euro-Med programme 2021 — 2027, Interreg IPA adriatic - ionian "IPA ADRION" 2021-2027", Rregullores Financiare të UAMD, Rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit, shkresën 2752 prot., date 25.11.2025 të Koordinatorit të projektit, Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit të shpenzimeve të projektit INTERREG/ "BLUE ECOSYSTEM" për periudhën 2025-2026, si vijon:
 - ✓ Vlera e financimit të projektit do të jetë për vitin 2025: 3 602 500 lekë, sipas zërave të përcaktuara në buxhetin e projektit.
 - ✓ Vlera e financimit të projektit do të jetë për vitin 2026: 1 752 500 lekë, sipas zërave të përcaktuara në buxhetin e projektit.
2. Burimi i financimit do të jetë nga të ardhurat e institucionit për vitin 2025.
3. Shpenzimet e kryera në kuadër të financimit të projektit të sipërcituar do të rimbursohen nga fondet e përfituara nga donatori në kuadër të projektit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Administratori
 - Drejtorja e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMITNr. 2914/6 Prot.Durrës, më 11 . 12 .2025V E N D I M
Nr 116 , datë 11.12 .2025**"PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QERA TË AMBIENTEVE NË KAMPUSIN
UNIVERSITAR TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU".**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", shkresës Administratorit nr.2865 prot., datë 09.12.2025 "Kërkesë për dhënie me qera", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies me qera të një ambienti me sipërfaqe 177.6 m², brenda godinës nr.2 të kampusit të ri të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Miratimin e dhënies me qera të një ambienti me sipërfaqe 198 m², brenda godinës nr.1 të kampusit të ri të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
3. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" Kreu III. Pika 1, Aneksi A, vlera e qerasë do të jetë jo më pak se 200 lek/ m².
4. Subjekti do të paguajë vetë të gjitha shpenzimet për furnizimin me energji dhe ujë.
5. Afati i kontratës do të jetë 12 muaj.
6. Shpërndarja e të ardhurave, për secilën nga objektet do të arkëtohen në llogarinë e të ardhurave të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas faturës të lëshuar nga Institucioni.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI BORDIT TE ADMINISTRIMIT**Ada ALIAJ**